



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



## VENDIM

Nr. 3 , datë 03/11/2020

### PËR PEZULLIMIN E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PUS SHPIMI

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr.111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.550, datë 15.7.2020 “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit të vendimmarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Zyres së Administrimit të Basenit Ujor Drin-Bunë, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë

## VENDOSI:

1. Miratimin e Pezullimit të Lejes Nr.6, datë 05/09/2017 “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR” për qëllime sanitare subjektit “BELLA CONFEX” shpk, me objekt “Rrobaqepësi-Konfeksione” për një afat 3-vjeçar.
2. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**MAJLINDA ANGONI**

